



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1653/7 prot.

Datë 21.08.2026

V E N D I M
Nr. 1027/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.08.2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AICOM” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-81553-04-09-2026, me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, me fond limit 15,090,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “AICOM” SHPK me NIPT L51714014K dhe adresë Rruga “Krist Maloki”, Ndërtesa me Kod Unik 8240013097, Numri i Pasurisë 2/122/ND1, Tiranë

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-81553-04-09-2026, me objekt: “Shërbim printimi,

fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, me fond limit 15,090,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 27-04-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 04.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. KALLFA Sh.p.k	11,080,529.28 lekë	skualifikuar
2. AICOM SHPK	11,136,427.2 lekë	kualifikuar
3. InfoSoft Office Sh.p.k	11,167,164 lekë	kualifikuar
4. TE ELECTRONICS SHPK	13,321,302 lekë	skualifikuar
5. IN PRINT SHPK	14,685,235 lekë	skualifikuar
6. PC STORE SHPK	14,997,672 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 26.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1653/2026 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6726 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-81553-04-09-2026, me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, me fond limit 15,090,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AICOM” SHPK, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 1653/1 prot., datë 28.05.2026.

II.7. Me shkresën me lëndë “Argumenta kundër ankesës së operatorit ekonomik Pc Store”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1653/2 prot., datë 02.06.2026, operatori ekonomik “Aicom” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar argumenta në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK.

II.8. Me shkresën me nr. 1753/7 prot., datë 04.06.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” shpk, lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr. REF-81553-04-09-2026, me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, protokolluar me tonën me nr.1653/3 prot., datë 05.06.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, vendim i KSHA-së nr. 94/2026 nga ku rezulton se e nuk e ka pranuar ankesën.

II.9. Me shkresën me nr. 1753/7 prot., datë 04.06.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” shpk, lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr. REF-81553-04-09-2026, me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, protokolluar me tonën me nr.1653/4 prot., datë 08.06.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, vendim i KSHA-së nr. 94/2026.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se janë paraqitur argumente nga subjekti i interesuar “Aicom” SHPK bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK, për kundërshtimin e kualifikimi të ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se: “[...] së pari, OBP sh.a, gjatë shqyrtimit të ofertave të paraqitura në SPE, duhet të kishte vlerësuar me vëmendje ofertën e “Infosoft Office” sh.p.k, pasi kemi dyshimin e arsyeshëm që dokumentat shoqëruese të ofertës nuk janë në përputhje me ndryshimet e akteve nënligjore në fushën e prokurimit publik. Konkretisht, referuar ndryshimeve në këtë formular, janë parashikuar shtim të seksioneve të vetëdeklarimit të gjendjes juridiko faktike, si vijon: operatori ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. sqarime nëse vlerësohet e nevojshme operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. sqarime nëse vlerësohet e nevojshme B: Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, deklaroj se: Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për

prokurimin publik”, të ndryshuar. Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me: a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë. nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë. kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj, ndryshime të cilat oe “Infosoft Office” sh.p.k nuk i ka reflektuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Gjithashtu, kemi dyshimin e arsyeshëm që: OE “Infosoft Office” sh.p.k.nuk ka plotësuar korrekt formularin vetëdeklarimit për të gjithë ortakët dhe drejtuesit direkt dhe indirekt të shoqërivë, sipas ekstraktit të QKB rezultojnë se pronarë, ortakë dhe persona me funksione drejtuese menaxhuese Infosoft Office janë shume persona konkretisht sipas ekstraktit të QKB: 1. F.P 2. G.D 3. Dobi Management shoqëri me përgjegjesi të kufizuar me vendim asambleje me kompetenca drejtuese menaxhuese përfaqësuese dyshojmë se nuk i ka plotësuar korrekt rubrikat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Në këtë kuptim, OE “Infosoft office” sh.p.k është në kriteret detyruese për skualifikim sipas nenit 76 të lpp dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe për rrjedhojë në mosplotësim të formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

[...] Për kriteret e përgjithshme të kualifikimit, konkretisht për pikat a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të lpp-së; d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të lpp-së; e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e republikës së shqipërisë, h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, të shtojcës nr. 9, të dokumentave të tenderit, operatori ekonomik “Infosoft Office”, nuk ka deklaruar dokumentin që vërteton përmbushjen e kriterëve si më sipër cituar, si dhe nuk ka deklaruar bazën e të dhënave ku ky dokument mund të aksesohet nga autoriteti kontraktor. Operatori ekonomik Infosoft Office nuk ka plotësuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr. 9, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

III.1.2. Në shtojcën nr. 10 “Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT dhe B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime _____ nëse _____ vlerësohet _____ e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

Ju lutemi sigurohuni që:

- ***Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.***
- ***Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.***
- ***Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.***
- ***Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.***

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- ***Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në***

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

- **Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.**
- **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.**
- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**
- **Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, datë 27.04.2026 të nënshkruar dhe vulosur.

III.1.4. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. 2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi; b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja

detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh; ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkëljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë; b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji; c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën; d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja; e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji. ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit; f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve

përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën 4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni. 5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. 6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë. 7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim. 8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmeshjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë

paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.8 Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se: “[...]Operatori ekonomik Infosoft Office nuk ka plotësuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se Agjencia Prokurimit Publik me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 “Për Miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E Hapur”, ka vendosur miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime, për procedurën e prokurimit e “E hapur”, në pikën 3 të tij përcaktohet se: 3.

Dokumentet Standarde të Tenderit të miratuara me Vendimin e APP Nr. 02, datë 09.06.2021 shfuqizohen. Nga verifikimi i dokumenteve standarde të publikuara nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka publikuar setin e dokumentave standarde për procedurën e prokurimit Procedurë e Hapur, sipas vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 10, datë 23.09.2024 “Për Miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me ndryshimet përkatëse konkretisht dhe të shtojcës 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në të cilin konstatohen ndryshime thelbësore edhe në përmbajtje të tij.

III.1.9 Në përmbushje të kriterit të parashikuar në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2/1.a Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST-së, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përmbushje të këtij kriteri ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik Shtojcën nr. 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të nënshkruar dhe vulosur.

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK Komisioni konstaton, se ky i fundit ka ofertuar sipas shtojcës 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, ku evidentohen të plotësuara rubrikat përkatëse ku përcaktohet se: *“Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate”*, si dhe për pikën ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi”*, si dhe evidentohet plotësimi i Deklaratës B: Deklarata “Për dorëzimin e ofertave të pavarura”, sipas “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, të ndryshuar.

Gjithashtu, nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, vërehet se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” ka dhënë të gjithë informacionin e mundshëm dhe dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni për të gjitha rubrikat që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit, duke përcaktuar institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi, si dhe duke përcaktuar adresën web të data bazës së të dhënave ku autoriteti kontraktor mund të kryejë verifikimet përkatëse parashikuar nga rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, ka deklaruar personin / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, duke deklaruar gjeneralitetet sipas ekstraktit të QKB.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 10, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke dhënë të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara më sipër në këtë vendim siç ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti

kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, KPP gjykon se operatori ekonomik ka plotësuar pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "PC STORE" SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "PC STORE" SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "Infosoft Office" SHPK me arsyetimin se: *"[...] së dyti, kemi dyshimin e arsyeshëm që OE "Infosoft Office" sh.p.k nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.2 të kapacitetit teknik në lidhje me pajisjet kundërshtojmë gjithashtu kualifikimin e OE "Infosoft office" sh.p.k, pasi nuk plotësohen kriteret lidhur me pajisjet e nevojshme si përmbushja e specifikimeve teknike të vendosura për pajisjet me të cilat do të kryhet shërbimi, si edhe deklarimin në formularin e vetedeklarimit për disponimin e tyre në një nga format ligjore të parashikuara (në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje). Konkretisht, AK ka kërkuar në dokumentat e tenderit tek pika 2.3.2 ka kërkuar si me poshte: 2.3.2 operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se disponojnë pajisjet e nevojshme (sipas specifikimeve teknike të shprehura në shtojcën nr.6) për zbatimin e kontratës, si vijon: nr. përshkrimi nj/m sasia 1 fotokopje/printer/skaner/ lazer/bardh/zi cope 40 2 fotokopje/printer/skaner lazer/me ngjyrapcope 20 3 fotokopje/printer/skaner lazer/bardh/zi cope 5 shuma e pajisjeve cope 65 për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: a. deklarate ku të cilesohet prodhuesi i paisjeve dhe nese keto pajisje ofertuesi i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje. b. katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. shenim: përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / ádo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas kodit civil të republikës së shqipërisë) për pajisjet e deklaruara. Kemi dyshime se OE Infosoft Office sh.p.k, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përmbushje të këtij kriteri lidhur me kataloget apo skedat teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve nëse janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara, duke qenë se pajisjet e sipërcituara, nuk prodhohen në shqipëri por janë brande ndërkombëtare, kërkohet të paraqiten katalogët e pajisjeve, të cilat duke qenë në gjuhë të huaj, duhet të paraqiten të përkthyer nga përkthyes zyrtar të njohur nga Ministria e Drejtësisë sipas ligjit nr. 82/2021 "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtarë, kriter për të cilin kemi dyshimin e arsyeshëm që Infosoft Office sh.p.k nuk e përmbush, pasi nuk i ka paraqitur*

në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Pra, kemi bindjen e plotë që “Infosoft Office” sh.p.k është kualifikuar nga AK në shkellje të ligjit, pasi nuk ka plotësuar piken 2.3.2 që ka të bëjë me specifikimet teknike të pajisjeve me të cilat do kryhet shërbimi. Gjithashtu lidhur me disponimin e pajisjeve, kemi bindjen se nuk ka plotësuar formularin e vetedeklarimit tek seksioni i mjeteve dokumentat provues me anë të të cilave provohet e drejta e pronësisë apo përdorimit për pajisjet e deklaruara në formularin e vetedeklarimit tek pjesa b: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën nr. 9, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

III.2.2. Në shtojcën nr. 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se disponojnë pajisjet e nevojshme (sipas specifikimeve teknike të shprehura në shtojcën Nr.6) për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Fotokopje/Printer/Skaner/ Lazer/Bardh/zi	cope	40
2	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/me ngjyra	cope	20
3	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/Bardh/zi	cope	5
	Shuma e pajisjeve	cope	65

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Deklarate ku të cilesohet prodhuesi i pajisjeve dhe nëse keto pajisje ofertuesi i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje.
- katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Shenim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) për pajisjet e deklaruara.

III.2.3. Në shtojcën nr. 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/kualifikimit, pika A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”, dhe pika B: DEKLARATË “Për disponimin e

punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ – <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- **Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.**
- **Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.**
- **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.**
- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.4. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes/kualifikimit, në pikën A: Deklaratë “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës” ka deklaruar si vijon: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha

specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikon e ekzekutimit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

- Në pikën B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar: Makineri e mjete Po [X], Jo []. Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: “Në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, të shtojcës 9 të DT-së, deklarojmë pajisjet si më poshtë: 1- Fotokopje/Printer/Skaner/Lazer/Bardh/zi, modeli “Ricoh MP402SPF”, Prodhuesi: Ricoh 40 copë – me kontratë qiraje. 2- Fotokopje/Printer/Skaner/Lazer/me ngjyra modeli “Ricoh IMC 300”, Prodhuesi: Ricoh, 20 copë- me kontratë qiraje. 3 – Fotokopje/printer/skaner/lazer/bardh/zi modeli “Ricoh IM 370F”, prodhuesi Ricoh: 5 copë-me kontratë qiraje. Për pajisjet e mësipërme, të marra me qera, deklarojmë se, disponojmë kontratat respektive të qirasë. Dokumentacioni i deklaruar do të vendoset në dispozicion sipas kërkesës tuaj”.
- Deklaratë, datë 27.04.2026 me përmbajtje si vijon: “Me anë të këtij dokumenti, shoqëria “Infosoft Office” SHPK, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, REF-81553-041-09-2026 në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të shtojcës 9 të DT-së deklaron se: Disponojmë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon: Fotokopje/printer/skaner/lazer/bardh/zi copë 40, fotokopje/printer/skaner/lazer/me ngjyra copë 20, fotokopje/printer/skaner lazer/bardh/zi copë 5, shuma e pajisjeve copë 65. Pajisjet “fotokopje/printer/skaner/lazer/bardh/zi” janë të kompanisë prodhuese “ricoh” – me kontratë qiraje. Pajisjet “Fotokopje/printer/skaner/lazer/me ngjyra”, janë të kompanisë prodhuese “ricoh- me kontratë qiraje”. Pajisjet “Fotokopje/printer/skaner lazer/bardh/zi janë të kompanisë prodhuese “Ricoh”-Me kontratë qiraje”. Për pajisjet e mësipërme, të marra me qera, deklarojmë se, disponojmë kontratat respektive të qirasë. Dokumentacioni i deklaruar do të vendoset në dispozicion sipas kërkesës tuaj”.
- Katalog “RICOH” MP 402SPF të shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. Rep *** datë 20.06.2024, dhe vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep ***, datë 20.06.2024.
- Katalog “RICOH” IM C300, IM C300F, IM C400F402SPF të shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. Rep *** datë 18.12.2024, dhe vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep ***, datë 18.12.2024.
- Katalog “RICOH” IM 370F, IM 460F, IM 460FTL të shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. Rep *** datë 20.06.2024, dhe vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep ***, datë 20.06.2024.

III.2.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund

t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohej për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
 - j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
 - k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërket të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

III.2.8. Në nenin 41, pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.10 Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se: *“Kemi dyshime se OE InfoSoft Office sh.p.k, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përmbushje të këtij kriteri lidhur me Kataloget apo skedat teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve nëse janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara, duke qenë se pajisjet e sipërcituara, nuk prodhohen në shqipëri por janë brande ndërkombëtare, kërkohej të paraqiten katalogët e pajisjeve, të cilat duke qenë në gjuhë të huaj, duhet të paraqiten të përkthyer nga përkthyes zyrtar të njohur nga ministria e drejtësisë sipas ligjit nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtarë, kriter për të cilin kemi dyshimin e arsyeshem që Infosoft Office” sh.p.k nuk e përmbush, pasi nuk i ka paraqitur në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Pra, kemi bindjen e plotë që Infosoft office sh.p.k është kualifikuar nga AK në shkelje të ligjit, pasi nuk ka plotësuar pikën 2.3.2 që ka të bëjë me specifikimet teknike të pajisjeve me të cilat do kryhet shërbimi. Gjithashtu lidhur me disponimin e pajisjeve, kemi bindjen se nuk ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit tek seksioni i mjeteve dokumentat provues me anë të të cilave provohet e drejta e pronësisë apo përdorimit për pajisjet e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit tek pjesa b: deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk në përmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit pikës 2.3.2 të shtojcës nr. 9 ka dorëzuar në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur ku në Pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes/kualifikimit, në pikën A: Deklaratë “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës” ka deklaruar si vijon: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohej nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor”.*

Në pikën B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohej) ka deklaruar: Makineri e mjete Po [X], Jo []. Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: *“Në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, të shtojcës 9 të DT-së, deklarojmë pajisjet si më poshtë: 1-*

Fotokopje/Printer/Skaner/Lazer/Bardh/zi, modeli “Ricoh MP402SPF”, Prodhuesi: Ricoh 40 copë – me kontratë qiraje. 2- Fotokopje/Printer/Skaner/Lazer/me ngjyra modeli “Ricoh IMC 300”, Prodhuesi: Ricoh, 20 copë- me kontratë qiraje. 3 – Fotokopje/printer/skaner/lazer/bardh/zi modeli “Ricoh IM 370F”, prodhuesi Ricoh: 5 copë- me kontratë qiraje. Për pajisjet e mësipërme, të marra me qera, deklarojmë se, disponojmë kontratat respektive të qirasë. Dokumentacioni i deklaruar do të vendoset në dispozicion sipas kërkesës tuaj”.

Deklaratë, datë 27.04.2026 me përmbajtje si vijon: “Me anë të këtij dokumenti, shoqëria “Infosoft Office” SHPK, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”, REF-81553-041-09-2026 në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të shtojcës 9 të DT-së deklaron se: Disponojmë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon: Fotokopje/printer/skaner/lazer/bardh/zi copë 40, fotokopje/printer/skaner/lazer/me ngjyra copë 20, fotokopje/printer/skaner lazer/bardh/zi copë 5, shuma e pajisjeve copë 65. Pajisjet “fotokopje/printer/skaner/lazer/bardh/zi” janë të kompanisë prodhuese “ricoh” – me kontratë qiraje. Pajisjet “Fotokopje/printer/skaner/lazer/me ngjyra”, janë të kompanisë prodhuese “ricoh- me kontratë qiraje”. Pajisjet “Fotokopje/printer/skaner lazer/bardh/zi janë të kompanisë prodhuese “Ricoh”-Me kontratë qiraje”. Për pajisjet e mësipërme, të marra me qera, deklarojmë se, disponojmë kontratat respektive të qirasë. Dokumentacioni i deklaruar do të vendoset në dispozicion sipas kërkesës tuaj”.

Katalog “Ricoh” MP 402SPF të shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. Rep ***, datë 20.06.2024, dhe vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep ***, datë 20.06.2024.

Katalog “RICOH” IM C300, IM C300F, IM C400F402SPF të shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. Rep *** datë 18.12.2024, dhe vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep ***, datë 18.12.2024.

Katalog “RICOH” IM 370F, IM 460F, IM 460FTL të shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. Rep *** datë 20.06.2024, dhe vërtetim njësie me origjinalin me

III.2.11 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar disponimin e pajisjeve të nevojshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor, si dhe ka përcaktuar formën e disponimit të këtyre pajisjeve duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat e autoritetit kontraktor, pra rezulton se ka deklaruar mjetet në shtojcën përkatëse, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, pika 2.3.2 e kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me përmbushjen e kriterit, mbi disponimin e mjeteve të kërkuara për realizimin me sukses të procedurës objekt shqyrtimi.

Gjithashtu, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar në SPE katalogjet për pajisjet përkatëse të shoqëruar me vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësimi me origjinalin.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt - ankimi, me dokumentacionin e dorëzuar përmbush pikën 2.3.2 të shtojcës nr. 9, të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.12. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se: “[...] nuk plotësohen kriteret lidhur me pajisjet e nevojshme si përmbushja e specifikimeve teknike të vendosura për pajisjet me të cilat do të kryhet shërbimi”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku i mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij, se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin.”

Sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimin e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.13. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësinë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Në përputhje me parimin e barrës së provës, operatori që ngre pretendimin ka detyrimin të paraqesë fakte, indicie ose prova konkrete për verifikime të mëtejshme. Në të kundërt, pranimi i kërkesave të pambështetura në prova do të sillte zvarritje të procedurës së prokurimit, cënim të parimit të efikasitetit dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues Komisioni gjykon, se operatori ekonomik nuk ka evidentuar konkretisht se cila prej pajisjeve të ofertuara nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor apo cilin prej specifikimeve teknike nuk përmbush siç është kapaciteti mbajtës, madhësia e letrës,

skanimit, dimensionit, ekrani, shpejtësia, teknologjia, resolucioni, pra nuk parashtrojnë indici apo prova, por ngre pretendim në total për të gjitha pajisjet, për të gjitha specifikimet teknike.

III.2.14. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indici të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një quasi gjykatë dhe refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim i cili nuk mbështetet në asnjë argument dhe nuk identifikon në mënyrë të qartë se cili prej dokumenteve të dorëzuara nuk përmbush kërkesat e autoriteti kontraktor, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “AICOM” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk qëndrojnë dhe gjendja faktike dhe juridike e këtij të fundit nuk do të ndryshojë pas arsyetimit të KPP-së, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-81553-04-09-2026, me objekt: “Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimit për DRSSH Tiranë”, me fond limit 15,090,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

